

UDHËZIM
Nr. 425, datë 24.7.2015

**PËR PRANIMIN, ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK DHE GRAFIK
TË PROJEKTIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN DHE LËSHIMIN E
AKTEVE TEKNIKE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 22, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 34/1/b, 41, të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, nenin 10 të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”,

UDHËZOJ:

1. Strukturat përkatëse të shërbimit të PMNZSH-së të qarkut pranojnë dokumentacionin tekniko-ligjor të planeve të detajuara vendore, lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit, që shoqërojnë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Shërbimi i PMNZSH-së kërkon plotësimin dhe administron nga shtetasit, subjektet fizike e juridike, pas kërkesës me shkrim dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Plotësimin e “Formularit informativ të përgjithshëm”, sipas modularit nr. 1, hartuar me kërkesat e shqyrtuara të projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin;
- b) Dokumentacionin grafik (Projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin);
- c) Relacionin teknik (të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin);
- d) Licencat profesionale, që duhet të shoqërojnë projektin përkatës;
- e) Leja profesionale e ekspertit privat zjarrfikës, kopje e noteruar dhe e sigluar vetëm për përdorimin në një objekt konkret;

f) Ekstraktin e regjistrimit të lëshuar nga QKR-ja, si dhe leja e konfirmuar nga QKL-ja për ekspertin zjarrfikës.

3. Dokumentacioni grafik i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin hartohet nga persona fizikë dhe juridikë që janë të pajisur me leje të lëshuar nga drejtoria e PMNZSH-së në përputhje me pikën 2 të nenit 34 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, si dhe ky dokumentacion pranohet në formatin jo më të madh se A2 dhe jo më të vogël se A3, i cili duhet përmbajë planimetrinë e përgjithshme të objektit në shkallën 1:2000 deri në 1:200, planimetrinë e shkallëve në shkallën 1:50 ose 1:200, si dhe:

- a) pjesën e projektit arkitekturor, arkitektonik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin;
- b) pjesën e projektit konstruktiv të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin;
- c) pjesën e projektit mekanik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin;
- d) pjesën e projektit elektrik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin i objektit;
- e) pjesën e projektit hidrik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin i objektit;
- f) skemat e evakuimit.

3.1.a Pjesa e projektit arkitekturor, arkitektonik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, paraqet grafikisht zbatimin e masave pasive të mbrojtjes nga zjarri të objektit, ose objekteve të projektuara, përkundrejt objekteve dhe infrastrukturës inxhinierike ekzistuese, ose të parashikuara në planin e detajuar vendor, si dhe skemën e masave të sigurisë, skemën e ndërhyrjes dhe veprimeve të mjeteve dhe personelit të PMNZSH-së në raste zjarri. Në projektet e planvendosjes së objektit/objekteve paraqiten të dhënat si më poshtë:

- Distancat e jashtme të sigurisë nga zjarri;
- Rezistenca ndaj zjarrit, përcaktimi i shkallës REI, i elementeve të jashtme konstruktive të godinës;
- Skema e vendosjes të mjeteve zjarrfikëse dhe dimensionimi i rrugëve të kalimit;
- Kapacitetin e dëndësisë së personave, në rrugëdaljet e evakuimit;
- Shkallët dhe ashensorët e brendshëm të kategorisë, “prova e tymit”.
- Shkallët dhe ashensorët e brendshëm të kategorisë “të mbrojtura”.
- Shkallët e sigurisë së jashtme;

3.2.b Pjesa e projektit konstruktiv të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin të objektit, ose objekteve të projektuara, paraqet grafikisht zbatimin e masave pasive të mbrojtjes nga zjarri të objektit, ose objekteve të projektuara, të strukturave ndërtimore, paraqet të dhënat si më poshtë:

- Kategoritë e mbrojtjes REI nga zjarri të gjithave strukturave mbajtëse horizontale dhe vertikale (trarë, soleta, dysheme, kolona, shkallë, kafaze ashensori, dalje të sigurisë të brendshme dhe të jashtme), në rastin e strukturave beton/arme ose të strukturave metalike;

- Kategoritë e mbrojtjes REI nga zjarri, të gjitha ndarjeve vertikale (mure, të brendshme dhe të jashtme të godinës);

- Kategoritë e mbrojtjes REI nga zjarri, të mureve perimetral e konstruktive të kateve nëntokë, si dhe të mureve kallkan të kateve mbitokë;

- Paraqet kërkesat dhe kategoritë e mbrojtjes nga zjarri të ndarjeve të objektit dhe të rrugëve të shpëtimit;

- Paraqet masat suplementare për rritjen e kategorisë së mbrojtjes nga zjarri dhe rezistencës së strukturave bazë nëpërmjet veshjeve specifike zjarrduruese në përputhje me normat përkatëse.

3.1.c Pjesa e projektit mekanik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, i objektit ose objekteve të projektuara, paraqet grafikisht zbatimin e normave të mbrojtjes aktive nga zjarri të impianteve mekanike të mbrojtjes dhe shuarjes së zjarreve, të cilat paraqiten sa më poshtë:

- Kategoritë e zjarreve për çdo ambient të objektit;

- Skemën horizontale, vertikale të evakuimit të personave;

- Projektin planimetrik të impiantit, ose impianteve fikse të shuarjes manuale ose automatike, vendosjen e hidrantëve, sistemeve detektim-sinjalizim në çdo kat të objektit.

3.1.d Pjesa e projektit elektrik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin të objekteve të projektuara, të cilat mbi bazë të kërkesave dhe parametrave të parashtruara në projektet urbanistike, arkitektonike dhe mekanike të mbrojtjes nga zjarri, paraqet grafikisht zbatimin e normave të mbrojtjes aktive, si më poshtë:

- Projektin e sistemit të diktimit-sinjalizimit, të gazrave, të tymrave, të nxehësishë.

3.1.e Pjesa e projektit hidrik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin të objekteve të projektuara paraqet grafikisht shpërndarjen e rrjetit hidrik për të mundësuar ndërhyrjen në të gjithë hapësirat e objektit. Paraqitjen grafike të përmasave të rrjetit hidrik, sipas tipologjisë së hidrantëve. Paraqitjen e karakteristikave hidraulike për garantimin e besueshëm të prurjeve të rrjetit, impiantin e fikjes automatike. Lidhjen me autopompën e mjeteve të strukturave zjarrfikëse, tipat e hidrantëve që do të vendosen në objekt.

4. Projekte dhe studime specifike të MNZSH-së janë projekte të cilat hartohen për objekte të veçanta me rrezikshmëri të theksuar zjarri, si p.sh:

- për depo dhe distributor të mëdhenj karburantesh, gazrash të lëngshëm dhe të djegshëm;

- linja transporti karburanti dhe gazesh;

- objekte ngarkim-shkarkimi të tyre, me mjete tokësore (autocisterna) ose detare (pontiglie);

- objekte përpunimi karburantesh dhe vajrash (rafineri);

- vendburime dhe platforma kërkimi nafte dhe gazi natyror;

- objekte përpunimi petro-kimike;

- objekte të përpunimeve, prodhimeve plastike;

- objekte përpunimi, prodhimi gome;

- objekte përpunimi, prodhimi bojërash me bazë solventi etj;

- objekte prodhimi të lëndëve plasëse;

- objekte përpunimit të grurit (fabrika mielli);

- objekte të përpunimit të tekstilit;

- objekte të magazinimit dhe përpunimit, konservimit të produkteve bujqësore, ose përpunim dhe prodhim të pijeve alkoolike;

- vajra ushqimore etj.;

- objekte kinematograficë;

- objekte përpunim letre dhe shtypshkronje;

- hangarët e avionëve dhe molet e skafeve;

- portet detare dhe aeroportet;

- miniera të kategorive karbonike etj.

a) Në projekte specifike do të përfshihen edhe objekte të cilët për nga kategoria e aktivitetit nuk paraqesin specifika të veçanta, si objektet e sipër- përmendura, por sipërfaqet e tyre janë të vlerësuara me një rrezik dhe potencial zjarri, për shkak të dimensioneve të mëdha, p.sh:

- qendra tregtare;

- fasoneri;

- komplekse spitalore;

- komplekse dhe resorte turistike,
- komplekse shkollore, komplekse sportive.

b) në objekte specifike do të përfshihen edhe objekte që përfaqësojnë vlera kombëtare historike, kulturore, arkeologjike.

5. Relacioni teknik i mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin duhet të përmbajë:

- a) pjesën e relacionit të projektit arkitekturor, arkitekturës urban;
- b) pjesën e relacionit të projektit konstruktiv të MNZSH-së;
- c) pjesën e relacionit të projektit mekanik të MNZSH-së;
- d) pjesën e relacionit të projektit elektrik të MNZSH-së.
- e) pjesën e relacionit të projektit hidrik të MNZSH-së.
- f) Pjesën e relacionit për skemat e evakuimit.

5.1.a Në pjesën e relacionit të projektit arkitekturor, arkitektonik për MNZSH-në përmban kushtet urbanistike të projektit të, duke bërë përshtatjen e kondicioneve urbanistike me normat e mbrojtjes pasive nga zjarri dhe për shpëtimin, si më poshtë:

- Përshkrimi i klasifikimit të godinës nga pikëpamja dimensionale, tipin e godinës (lartësinë e godinës mbi tokë, numrin e kateve nën tokë, sipërfaqen maksimale të ndarjeve dhe nëndarjeve;
- Përshkrimi i kategorisë së objektit sipas përdorimit dhe përputhjen me distancat e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
- Përshkrimi i distancave të jashtme të sigurisë nga zjarri.
- Rezistenca ndaj zjarrit-përcaktimi i shkallës REI, i elementeve të jashtme konstruktive të godinës.
- Skema e vendosjes të mjeteve zjarrfikëse dhe dimensionimi i rrugëve të kalimit.
- Kapacitetin e dendësisë së personave (fluksin e daljeve), në rrugëdaljet e evakuimit;
- Shpjegime mbi zgjedhjen e skemës së sistemit të evakuimit, gjatësitë dhe gjerësitë e korridoreve, gjerësitë e shkallëve, numrin të shkallëve dhe daljet e sigurisë të brendshme dhe të jashtme;
- Shpjegime dhe llogaritje për ventilimin natyral të godinës dhe largimin e tymrave, për katet nën nivelin zero dhe parkimet nëntokësore;
- Përshkrim lidhur me llojin dhe kapacitetin e lëndëve djegëse që lejohen të përdoren në objekt, gjatë shfrytëzimit me destinacion shërbime, restorante, kaldaja qendrore për ngrohje, ftohje, etj.) dhe kushtet teknike të ventilimit, detektimit, sinjalizimit;

5.1.b Në pjesën e relacionit të projektit mekanik për MNZSH-së përmban zbatimin e normave të mbrojtjes aktive nga zjarri të impianteve mekanike të mbrojtjes dhe shuarjes së zjarreve, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Kategoritë e zjarreve për çdo kat të objektit;
- Skemën horizontale, vertikale të evakuimit të personave;
- Projektin planimetrik të impiantit ose impianteve fikse të shuarjes manuale ose automatike, vendosjen e hidrantëve, sistemeve sinjalim-detektimit në çdo kat të objektit;
- Përshkrimi teknik i rrjetit të tubacioneve të shpërndarjes dhe furnizimit me ujë të hidrantëve, të sistemit të sprinklerave, etj.;
- Përshkrimi teknik i sistemeve specifike të tjera, siç mundet të jenë sistemet fikëse të shuarjes me shkumë, me pluhur, me gaz halogjen, me aerosolë;
- Përshkrim i sinjalistikës pamore dhe zanore, të daljeve të rrugëve të evakuimit.

5.1.c Në pjesën e relacionit të projektit elektrik për MNZSH-së projektuesi përshkruan mbrojtjen aktive të objektit, të cilat mbi bazë të kërkesave dhe parametrave të parashtruar në projektet urbanistike, arkitektonike dhe mekanike të mbrojtjes nga zjarri, do të paraqesë normat dhe llogaritjet bazë të projektit, si dhe përshkrimin e elementeve të këtyre impianteve. Për këtë qëllim ai do të paraqet sa më poshtë:

- Përshkrimin e sistemeve teknike të diktimit-sinjalizimit dhe të dhënave teknike të detektorëve automatik të gazrave, tymrave dhe të nxehësisë;
- Përshkrimin e sistemeve të sinjalizimit zanor në objekt, të sinjalizimit dhe lajmërimit automatik telekomunikativ nga centrali i zjarrit me repartet zjarrfikëse të bashkisë, me/ose me personat përgjegjës dhe specifikimet teknike të komponentëve.
- Përshkrimi i sistemeve të kontrollit dhe komandimit të sistemeve parandaluese, të shuarjes së zjarrit dhe evakuimit të tymrave.
- Përshkrimin e sistemeve të fuqisë elektrike të stacioneve të pompimit, të ndriçimit emergjent dhe daljeve të sigurisë.

5.1.d Në pjesën e relacionit të projektit hidrik të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin të objekteve të projektuara përshkruhet hollësisht shpërndarja e rrjetit hidrik, i cili mundëson ndërhyrjen në të gjithë hapësirat e objektit. Përshkrimi i hollësishëm i përmasave të rrjetit hidrik, sipas tipologjisë së hidrantëve. Përshkrimi i karakteristikave hidraulike për garantimin e prurjeve të rrjetit, përshkrimi i tipit të impiantit të fikjes automatike. Lidhjen me autopompën e mjeteve të strukturave zjarrfikëse.

6. Pranimin nga strukturat e shërbimit të PMNZSH-së të kërkesës për lëshimin e aktit teknik, detyrim germës “b”, të pikës 1, të nenit 34 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar nga shtetas, subjekte fizike e juridike, vetëm pas plotësimit të rregullave, normave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, për të gjitha kategoritë e objekteve, para vënies së tyre në shfrytëzim.

7. Pas kërkesës për lëshimin e aktit teknik, shërbimi i PMNZSH-së verifikon dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, si dhe planifikon verifikimin në terren të objektit dhe këqyr me përgjegjësi zbatimin e projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin.

8. Punonjësi PMNZSH-së pas verifikimit në terren dhe fotografimit të objektit harton relacion me shkrim lidhur me gjendjen faktike të masave pasive, aktive për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në objektin e verifikuar. Nëse janë respektuar kërkesat e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, shërbimi i PMNZSH-së i jep aktin teknik kërkuar. Në të kundërt atij i lihet kohë e mjaftueshme për plotësimin e masave për mbrojtjen pasive dhe aktive të objektit të verifikuar. Pas shterimit të afatit të lënë dhe riverifikimit faktik në objekt, kur konstatohen shkelje të dispozitave për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin merren masa administrative, sipas përcaktimeve të nenit 38 (veprimi administrativ) të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar.

9. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 dhe pikën 7 të këtij udhëzimi administrohen nga shërbimi i PMNZSH-së në dosje të veçanta për çdo objekt, si dhe ruhen dhe administrohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

10. Shenjat konvencionale dhe treguese të unifikuara që do të përdoren nga projektuesit për projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin janë sipas modularit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Punonjësit e PMNZSH-së, që merren me pranimin dhe verifikimin e dokumentacionit, shqyrtimin e projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, këqyrjen e objekteve në teren, lëshimin e akteve administrative, detyrim edhe i legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit mbajnë përgjegjësi për mosrespektim të dispozitave të ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar. Për shkeljet e konstatuara, kur nuk përbëjnë vepër penale, ndaj personave përgjegjës merren masa administrative sipas legjislacionit në fuqi.

12. Me njohjen, ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen sektorët e PMNZSH-së në institucionin e prefektit të qarkut, ndërsa për kontrollin ngarkohet Drejtoria e PMNZSH-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

Nr. Pratikës Z.F.

vula

FORMULARI INFORMATIV I PËRGJITHSHËM

SHËRBIMI I POLICISË SË MBROTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN
SEKTORI I PMNZSH

QARKU			
I nënshkruari	Emri		Mbiemri
Banues në	adresa	Numeri i identifikimit të lehtënjohësimit	Bashkia
	telefoni	C.F.	Numeri i NIPTIT të personit fizik
	telex	Adresa e postës elektronike	
Në cilësinë e	Kapaciteti zyrtar (pronari, përfaqësuesi ligjor, avokat, administrator, menaxher, etj)		
dhe	Firma e enra, ndërmarrje, institucion, korporatë, shoqësi, person juridik, fizik etj		
Bazuar në	adresa		
	Bashkia	zona	telefoni
	telex	Adresa e postës elektronike	

Në përputhje nenin 30, pika 1 e nenit 32 të ligjit nr.8766, datë 05.04.2001 "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin", i ndryshuar bëhet:

VLERËSIMI I PROJEKTIT

Për objektet e	Lloji i punës (zgjidhjes së re, modifikim, zgjerim, rinovim, etj)		
Aktiviteti lidhur	Lloji i objektit, lloji i biznesit, aktivitetit (objekt banor, hotel, shkollë, etj)		
Të vendosura në	adresa	Numeri i identifikimit	
	Bashkia	zona	telefoni
t			
Dokumentacioni teknik është nënshkruar nga eksperti zjarrfikës			
Numeri i lejes	Emri	Mbiemri	
Eksperti zjarrfikës regjistruar në studio projektimi	Nr. regjistrimit		
	adresa	Numeri i regjistrimit NIPT	
c.a.p.	Bashkia		
telefon	Adresa e postës elektronike		

Hapësira për shënime për sektorin e PMNZSH të Qarkut.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

a) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME LIDHUR OBJEKTIN DHE AKTIVITETETIN QË USHTROJET LIDHUR ME MASAT E MBROTJES NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN.

b) TREGUESIT DHE MËNYRAT E NDËRHYRJES NË PROJEKT: INSTALIMI I RI OSE MODIFIKIM, ZGJERIMIN APO RISTRUKTURIMIN I AKTIVITETETIT EKZISTUES.

Bashkëlidhur këtij formulari paraqiten nga prijektuesi i autorizuar apo investitori dokumentet e mëposhtme të projektit, e nënshkruar nga një ekspert zjarrfikës i licensuar në përputhje me pikën 2 të nelt 34 të ligjit nr.8766, datë 05.04.2001:

- Relacioni teknik;
- Dokumentacioni grafik.

SHENJAT KONVENCIONALE DHE TREGUESE TË DOKUMENTACIONIT TEKNIK DHE GRAFIK TË PROJEKTIT TË MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN

Fushëveprimi.

Ky kapitull paraqet simbolet që do të përdoren në vizatime dhe diagram për paraqitjen grafike të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në objekte.

Qëllimi.

Qëllimi i këtij kapitulli është të sigurojë uniformitet në përdorimin e sigurisë nga zjarri dhe simboleve të lidhura në përgatitjen e vizatimeve dhe diagrameve në projektin e MNZSH-së.

Shqyrtimi i Vijave.

Vijat në këtë kapitull nuk do të konsiderohen pjesë e simboleve, por do të përdoren për të përfaqësuar tubacionet, instalime elektrike, apo sipërfaqe që lidhen me simbolin.

Shkalla e Simbolit.

Të gjitha shkallët për simbolet në çdo vizatim do të jenë në të njëjtën madhësi relative

Orientimi.

Simbolet do të orientohen në mure, tuba, linjat elektrike, dhe kështu me radhë për cilat ata janë lidhur.

Simbolet karakteristike për pozicionin/qëndrimin.


Ndërtesat.

Muret e jashtme të ndërtesave do të konturohen me vija me trashësi teke, në qoftë se nuk përfshihen nga zjarri dhe vija me trashësi të dyfishta nëse përfshihen nga zjarri.

Perimetri i tendave, qepenave dhe strukturat e tjera, siç janë daljet ose mure të hapura do të tregohen me vija të thyera.

Hekurudhat.

Hekurudhat dotë tregohen me vijë të kryqëzuar.



Rrugët.

Rrugët do të tregohen.

Furnizimi me ujë.

Lumenjtë, liqenet, pellgjet ujëmbledhës etj, do të skicohen.

Gardhe rrethuese.

Gardhet do të paraqiten nga vija me X'S me ndarje në mënyrë të barabartë

Hyrjet e portave do të tregohen

Përcaktimi i vijave

Simbolet e dhëna më poshtë do të tregojnë karakteristikat e vijave.

Stacioni Zjarrfikës.

Simbol për të drejtën e hyrjes së zjarrfikëseve do të jetë si më poshtë:



Simbolet për konstruksionin e dërtesave.

Llojet e konstruksionit të ndërtesave

Llojet e konstruksionit do të tregohen si më poshtë.

Lartësia.

Lartësia do të tregohet për të treguar numrin e sipërfaqes, numri e themeleve nën tokë, dhe pjerrësinë e tendës.

Simbolet për muret mbrojtëse me rezistencë ndaj zjarrit.

1. Muri

2. Muri ulët.

3. Hapja në Mur.

4. Perde Tymi

Mur që ka një rezistencë ndaj zjarrit (REI) prej jo më pak se ½ ore

Vlerësimi i rezistencës 1/2-ore (pengesë/perde tymi)

1. Vlerësimi i rezistencës 3 /4- ore

2. Vlerësimi i rezistencës 3 /4- ore (Shtresa Mbrojtëse e tymit)

3. Vlerësimi i rezistencës 1 orë

4. Vlerësimi i rezistencës 1 orë / (shtresa mbrojtëse e tymit)

5. Vlerësimi i rezistencës 2 orë

6. Vlerësimi i rezistencës 2 orë / Shtresa Mbrojtëse e tymit

7. Vlerësimi i rezistencës 3 orë

8. Vlerësimi i rezistencës 3 orë / Shtresa Mbrojtëse e tymit

9. Vlerësimi i rezistencës 4 orë

10. Vlerësimi i rezistencës 4 orë / Shtresa Mbrojtëse e tymit


11. Hapja e derës me një vlerësim rezistencës së zjarrit më pak se 3 orë

12. Ashensor me boshtë që digjet/merr flakë.

13. Ashensor me boshtë të padjekshëm.

14. Escalator.

15. Shkallë të djegshme.



16. Çati ose dysheme zjarrduruese.

17. Tra druri për dysheme ose çati.

18. Çatia / montimi i dyshemesë

19. Baza e dyshemesë.

20. Ndërtimi i çative.

Kombinimi i karakteristikave.

1. Bojler.

2. Oxhak.

3. Dalje urgjente .

4. Autobote, Çisterna, Horizontale.

5. Autobote, Çisterna, Vertikale.

6. Depozita, Çisterna

Simbolet e furnizimit me ujë dhe shpërndarja.

Tubacionet kryesore të furnizimit me ujë.

1. Sistemi ujq nga ujësjellësi publik.

2. Sistemi ujq privat.

3. Tubacioni kryesor i nëndheshëm.

4. Tub Thithës.

5. Pengesë.

6. Shpërndarës.

7. Valvula.

8. Valvula nën Tokë.

9. Valvul-Statike Treguese.





10. Valvul me Hapje-Mbyllje.

11. Valvul OS & Y .

12. Valvul flutur me termostat (tregojnë pozicionin e një valvule nëse është e hapur ose e mbyllur)

13. Këto valvula nuk tregojnë një pozicion të hapur ose të mbyllur

14. Valvul Kontrolli.



15. Valvul parandaluese e kthimit mbrapsht -tipi dyshe.


16. Valvul parandaluese e kthimit mbrapsht,

17. Valvul për rregullimin e presionit.

18. Valvul për ngushtimin e presionit.

19. Valvul lëvizëse, galixhant.

20. Metër.



Simbolet e sistemit tëhidranteve.

1. Hidrante me nje dalje.

2. Hidrante me dy dalje.

3. Hidrante me dy dalje, dhe lidhje me pompën.

4. Hidrante muri, me dy dalje.

5. Hidrante banese me dy dalje.

6. Hidrante në stacionin zjarrfikës.


7. Hidrante në stacion zjarrfikës me dy dalje qëndrim të lirë.

8. Hidrant zjarrfikës me nje dalje.

9. Hidrant i vendosur në trotuar.

10. Hidrant i montuar në mur.

11. Pompa zjarri me lëvizje.



Simbole të shërbimit zjarrfikës për kontrollin e panelit.

1. Paneli i kontrollit për alarmin e zjarrit

2. Sistemi sinjalizimit të zjarrit

3. Transmetuesi i alarmit të zjarrit

4. Pozicioni i Ashensorit/Rikthimi

5. Komunikator i alarmit të zjarrit


6. Kontrolli Panelit të Lëshimit të Ujit

7. Kontrolli i panelit për nxehësinë, ventilimi, air-condicionimi,

Simbolet zjarrfikëse lidhur me mjetet e daljes.



1. Ndriçim emergjent me Bateri.



2. Tabela e daljes e ndriçuar, njëra anë e tabelës.



3. Tabela e daljes se ndriçuar, dy anët e tabelës.



4. Kombinimi i tabelës dalëse me drita të ndriçuara.




Simbolet për alarmet e zjarrit, zbulimin, dhe pajisjeve.

Aparat për fillimin e sinjalit dhe tingëllimi.


1. Bombol për shuarjen e zjarrit



2. Bombol me dyoksid karboni



3. Bombol me gaz kimik



4. Bombol me shkumë




5. Kutë për alarmin në rast zjarri



6. Gaz i pastër



7. Shpërndarës uji



8. Sprinkler spërkatës



Simbole të shërbimit telefonik zjarfikëses.

1. I arritshëm



2. Fiks



3. Celular



Simbole të aparateve për lëshimin e alarmit zjarfikës.

1. Sensor për lëshimin e ujit



2. Sensor për dyoksid karboni



3. Sensor për gaz kimik



4. Sensor për shkumë



5. Sensor pastrues



6. Shpërndarës uji



7. Sprinkler shpërndarës



Simbole për sisteme automatike dhe pajisje mbikëqyrjeje të zjarfikësës. Detektor nxehtësie (Detektor termik)

1. Kombinim – Shkalla e nisjes dhe Temperatura e vendosur



2. Shkalla e Dëmtimit




3. Temperatura e Caktuar



4. Vetëm Shkalla e Nisjes



5. Detektor me kabull (kabull i ndjeshëm nga nxehtësia)



Detektor Tymi.

1. Detektor fotoelektrik për produktet e djegura



2. Detektor jonizues për produktet e djegura



3. Transmetues Drite



4. Marrës Drite



5. Vrojtim Ajri



6. Detektor tymi me tub.




7. Detektor gazi.




8. Detektor flake.




9. Detektor lëvizës / me Tingu



10. Detektor shtytës / me Tingu



11. Detektor i sheshtë / me Tingu



Sinjalet akustike.

1. Altoparlant elektrik.



2. Mini-Autoparlant



3. Zile (Gong).



4. Alarm Uji (Motor Uji Gong).



5. Autopolantët me Dritë ndahen sipas montimit



6. Autopolantët me Dritë si një trup i tërë



7. Fener (llampatinë, dritë Sinjalizuese, fenelina).



Simbolet për sistemin e shuarjes së zjarrit.

Tipe të ndryshme sistemesh për shuarjen e zjarrit.

Sistem me Ujë

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual



Sistem me Gaz.

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual



Sistemi me shkumë.

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual



Sistemi me gaz për shuarjen e zjarrit.

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual



Sistemi me Kimikate të lëngshme.

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual



Për të gjitha llojet e di egjes (përveç metaleve).

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual



Sistemi i fikjes së zjarrit me dyoksid karboni.

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual



Sistemi i fikjes së zjarrit me gaz halon.

1 Vihet në veprim Automatik



2 Vihet në veprim Manual

Simbolet për sprinklerat e zjarrit.

1. Sprinkler i varur.
2. Sprinkler në pozicion vertikal.
3. Sprinkler i varur, me kokë poshtë.
4. Sprinkler, me mbrojtës.
5. Sprinkler në mur anësor.
6. Sprinkler i jashtëm.
7. Hapësira të mbushura me sistem sprinkler.
8. Hapësira të mbushura pjesërisht me sprinklera.
9. Hapësira pa sprinklera.
10. Sistemi me ujë spërkatës.



Simbolet për tubat, valvulat, pajisje kontrolli, dhe varëset.

1. Varëse tubash.
2. Valvul këndore (tub valvule këndore).
3. Valvul kontrolli me alarm.
4. Valvul me tub.
5. Valvul me tub dhe me pajisje për hapje të shpejtë
6. Valvul me sistem rrjedhës
7. Valvula Vepruese.



Simbole për fikset e dorës (manual).

1. Fikse Zjarri me Ujë.
2. Fikse Zjarri me shkumë.
3. Fikse zjarri me Gaz kimik.
4. Fikse zjarri me gaz CO₂.



5. Fikse zjarri me Gaz Halon.



6. Fikse zjarri për metalet.



7. Pajisje për shuarjen e zjarrit.



8. Bobinë me CO₂.



9. Bobinë me kimikate



10. Bobinë me Shkumë.



11. Vendqëndrimi për tubin kimik.



12. Vendqëndrimi për tubin e mbushur.



13. Monitor tubi, i thate.



14. Monitor tubi, i ndryshueshëm.



Simbolet për tynin/kontrolli i presionit.

1. Ventilator.



2. E përgjithshme.



3. Tubacion.



4. Çati.



5. Mur.



6. Zjarr.



7. Tym.



8. Zjarr/Tym.



9. Barometër.



10. Kafaz Shkallësh.



11. Hapja e Ajrimit.



Simbolet e shndritshme.

Kontejner për mbajtjen e materialit.



1. Shkumë



2. Halon



3. Dyoksid Karboni



4. Gaz Kimik



5. Sprinkler




Simbolet për dyer zjarrduruese.

1. E pacaktuar




2. E pacaktuar qëndrueshmëria-tymit



3. 20-minuta vlerësimi i zjarrit.



4. 20-minuta vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



5. 1/2-orë vlerësimi i zjarrit



6. 1/2-orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



7. 3/4-orë vlerësimi i zjarrit.



8. 3/4-orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



9. 1- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



10.1- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



11.1¹/₂- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



12.1¹/₂- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



13.2- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



14.2- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



15.3- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



16.3- orë vlerësimi i zjarrit, qëndrueshmëria-tymit



Daljet

- 1 Dalje e drejtë.
- 2 Dalje e lirë.

